


“Rishikimi i vizave do ta vriste dialogun”, Osmani kritikohet për gjuhë jodiplomatike | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ANALISTËT: ZGJEDHJET PËRMES PETICIONIT NUK PRITET TA ZGJIDHIN SITUATËN NË VERI TË KOSOVËS



Qeveria e Kosovës pritet që gjatë javës së ardhshme t'i përfundojë aktet nënligjore që i hapin rrugë petitionit për shkarkimin e

kryetarëve në veri të Kosovës dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja. Por analistët politikë thonë se zgjedhjet përmes petitionit nuk

pritet ta zgjidhin situatën në veri. Sipas tyre, shkuarja në zgjedhje përmes petitionit do ta zvarrisë procesin e zgjedhjeve në tërësi

## ISH-PRESIDENTI THAÇI VJEN NË KOSOVË PËR VIZITË FAMILJARE

FAQE 4



## SA KA SHPENZUAR KOSOVA NË MIRËQENIE SOCIALE?

FAQE 5

### AKTUALE



**BIDENI ZOTOHET SE DO TË OFROJË NDIHMË PËR RIMËKËMBJE TË FLORIDËS PAS STUHISË** F. 2

**PRISHTINA E NGARKUAR ME VETURA, TRANSPORTI PUBLIK SHIHET SI ZGJIDHJE** F. 6

**KLINIKA E PEDIATRIKË E STËRMBUSHUR ME PACIENTË, DY FËMIJË TË SHTRIRË NË NJË SHTRAT** F. 6

### EKONOMI



**BQK-ja: QYTETARËT E KOSOVËS RRETH 50 PËR QIND TË SHPENZIMEVE I PËRDORËN GJATË UDHËTIMEVE NË SHQIPËRI** F. 7

**ALEANCA E BIZNESIT: RRETH 17 MIJË TË RINJ NË KOSOVË PRESIN NGA PESË VJET PËR T'U PUNËSUAR** F. 8

### SPORT



**BALLKANI SHKËLOEN EDHE NË SUPERLIGË** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni zotohet se do të ofrojë ndihmë për rimëkëmbje të Floridës pas stuhisë

WASHINGTON, 3 SHTATOR - Presidenti amerikan Joe Biden, është zotuar se do të ofrojë çfarëdo ndihme për Floridën për t'u rimëkëmbur pas shkatërrimit që ka lënë mbrapa stuhia tropikale Idalia. Bideni i ka bërë këto deklarata nga vendi i ngjarjes, ku të paktën dy persona besohet të kenë vdekur prej zbarkimit të stuhisë të mërkurën në këtë shtet. Bideni ka thënë se asnjë njeri "inteligjent" nuk ka dyshim për ndikimin e


ndryshimeve klimatike në stuhi të tilla. Guvernatori i Floridës, Ron DeSantis, ka vendosur të mos takohet me presidentin Biden. DeSantis, i cili synon ta fitojë nominimin e republikanëve në garën për president të ShBA-së, ka thënë paraprakisht se prania e Bidenit në Florida do t'i pengonte përpjekjet për përgjigje ndaj katastrofës. Bideni, i cili ka biseduar disa herë me DeSantisin gjatë javës përmes telefonit, ka thënë se

do të shkojë edhe fizikisht në Florida. Idalia ka zbarkuar si stuhi e fuqishme në zonën Big Bend të Floridës të mërkurën dhe është përshkruar nga zyrtarët si stuhia më e keqe që e ka goditur rajonin në 100 vitet e fundit. Prej asaj dite stuhia ka lëvizur në veri, duke goditur shtetet fqinje si Xhorxhia dhe dy Karolinat. Shtëpitë dhe bizneset janë vërshuar, dhe mijëra njerëz kanë mbetur pa energji elektrike.



## NASA zbulon një krater të ri në Hënë

WASHINGTON, 3 SHTATOR - Administrata Kombëtare amerikane e Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA) ka zbuluar një krater të ri të vogël në Hënë që, me gjasë, është krijuar nga përplasja e një sonde ruse që tentoi të ulej në sipërfaqen hënore rreth dy javë më parë. Këto gjetje i bëri sonda Lunar Reconnaissance Orbiter (LRO), që krahasoi imazhet para dhe pas në pikën e impaktit. Imazhet u ofruan nga agjencia ruse e hapësirës, Roscosmos, raporton Rel. Sonda Luna-25 u rrëzua më 19 gusht, duke shuar shpresat e



Moskës që ta ringjallë programin e saj për udhëtimet drejt Hënës, pasi Rusia synonte të bëhej shteti i

parë që do të zbarkonte në polin jugor hënor. Por, India arriti që me sukses ta ulte sondën e sanChandaryaan 3.

Zbarkimi i sondës në polin jugor hënor ndodhi më 23 gusht dhe sonda aktualisht është duke eksploruar këtë zonë. LRO, që është duke u rrotulluar rreth Hënës që nga viti 2009, fotografitë para përplasjes së sondës ruse i realizoi në qershor të vitit 2022. Këto imazhe u krahasuan me fotografitë e realizuara më 24 gusht 2023. "Pasi që krateri i ri është afër vendit ku u përplas Luna-25, ekipi i sondës LRO erdhi në përfundim se ka të ngjarë që krateri të jetë shkaktuar nga kjo ngjarje e jo nga ndonjë

ndikim natyror", u tha në deklaratën e NASA-s. Krateri i ri është rreth 10 metra në diametër dhe rreth 400 kilometra nga vendi ku Luna-25 ishte paraparë të zbarkonte. NASA, po ashtu, planifikon t'u kthehet misionëve të Hënës përmes programit Artemis, që synon të krijojë një prani të qëndrueshme në hapësirën hënore. Akulli që gjendet në Hënë mund të shfrytëzohet për t'i mbështetur habitatet njerëzore ose mund të ndahet në hidrogjen dhe oksigjen që më pas të përdoren si lëndë djegëse për raketat.

## Franca planifikon t'i ndalojë cigaret elektrike njëpërdorimshme



PARIS, 3 SHTATOR - Franca planifikon t'i ndalojë cigaret elektrike njëpërdorimshme, ka thënë kryeministrja e këtij vendi, Elisabeth Borne, për radion RTL të dielën. "Është çështje e rëndësishme për shëndetin publik", ka thënë Borne, duke shtuar se qeveria është duke hartuar programe kombëtare për luftim të cigares, e cila, sipas saj, është

përgjegjëse për 75 000 vdekje brenda një viti në Francë. Sipas kryeministres, pajisjet e ashtuquajtura "puff" mund të krijojnë shprehi të të rinjtë, të cilët më vonë mund të krijojnë varësi nga cigarja. Megjithatë, ajo e ka përmendur se qeveria franceze nuk planifikon t'i rrisë taksat në cigare vitin e ardhshëm pas rritjes së këtij

viti. Presidenti francez Emmanuel Macron pati publikuar më 2021 disa plane ambicioze për luftim të cigares dhe alkoolit, duke u zotuar për krijim të më shumë hapësirave publike ku nuk pihet cigarja dhe që 20-vjeçarët që jetojnë në Francë më 2030, të mos jenë konsumues të cigares.

## Indonezia ofron "viza të arta" për t'i joshur investitorët e huaj

XHAKARTA, 3 SHTATOR - Indonezia është duke e paraqitur një skemë të re vizash për t'i joshur individët apo korporatat e huaja, në tentim e sipër për ta rritur ekonominë e shtetit. "Viza e artë garanton leje të qëndrimit për periudhë prej pesë deri në 10 vjet", ka thënë drejtori i përgjithshëm për

Imigracion në Indonezi, Silmy Karim. Viza pesëvjeçare u kërkon investitorëve individualë të hapin kompani në vlerë të 2.5 milionë dollarëve, ndërsa për vizë dhjetëvjeçare duhet bërë investim prej 5 milionë dollarësh. Edhe shtete të tjera në botë, përfshirë Shtetet e Bashkuara,

Irlandë, Zelandën e Re dhe Spanjën, ofrojnë viza të ngjashme për investitorët. Sa iu përket investimeve nga korporatat, Indonezia do të kërkojë investim prej 25 milionë dollarëve për leje qëndrimi prej pesë vjetësh dhe shumë prej 50 milionë dollarëve për periudhë 10-vjeçare.



# Ish-presidenti Thaçi vjen në Kosovë për vizitë familjare

## “Epoka e re”

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, po vazhdon të qëndrojë në Kosovë, pasi është lejuar nga Dhomat e Specializuara që ta vizitojë babanë e vet, në gjendje të rënduar shëndetësore. Kjo është hera e dytë që brenda këtij viti, për arsye të njëjta, Specialja e ka lejuar ish-presidentin Thaçi të vijë në Kosovë. Megjithatë, jo të gjitha kërkesat për vizita me arsye humanitare të të akuzuarve të speciale, janë miratuar.

Haga shfaqet rrallë në tabelën informuese të fluturimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, pasi nuk ka një linjë direkte të fluturimeve ndërmjet këtyre dy qyteteve dhe çdo fluturim zhvillohet në mënyrë të veçantë.

Një i tillë ndodhi të shtunën, kur në Kosovë u soll ish-presidenti Hashim Thaçi.

Gjendja e rënduar e babait të Thaçit, i bindi Dhomat e Specializuara që atij t’ia lejojnë një vizitë humanitare në vendlindje.

Lajmin Specialja e konfirmoi edhe përmes një komunikate për publikun. “Për arsye detyruese humanitare, Trupi Gjykses ka udhëzuar sekretarin që të menaxhojë një vizitë paraburgimi në Kosovë për Hashim Thaçin për takim me familjen”, ka njoftuar Gjykata

Speciale.

Thaçi të shtunën ka qëndruar rreth dy orë në shtëpinë e tij në fshatin Burojë, përderisa shumicën e kohës do ta kalojë në objektet e EULEX-it.

Gjatë qëndrimit në Kosovë avokati Ardian Bajraktari vlerëson se të akuzuarve nga Specialja do të duhej t’u ofrohej më shumë liri. “Kanë shprehur gatishmërinë e plotë për t’u ballafaquar edhe me akuzat, mirëpo edhe për të bashkëpunuar me organet përkatëse që zhvillojnë procedurat. Prandaj, natyrisht që kjo do të duhej të merrej në konsideratë nga ana e panelit dhe rrjedhimisht të ketë më tepër tolerime të tilla”, ka thënë Bajraktari.

Qëndrimi mbi dyvjeçar në paraburgim ka bërë që ish-krerët e UÇK-së të kenë kërkesa të shpeshta për vizita me arsye humanitare në Kosovë, mirëpo jo të gjitha janë aprovuar. “Duke qenë se rregulla së cilës iu referova nuk përcakton kriteret të qarta, atëherë natyrisht se dhënia e kësaj mundësie në diskrecion të panelit, ndoshta ndonjëherë ka pasur edhe raste kur kërkesa është refuzuar dhe rrjedhimisht i ka vënë në pozitë të pabarabartë personat të cilët ndodhen në Qendrën e Paraburgimit”, ka shtuar Bajraktari.

Një rast të dështimit të vizitës për arsye humanitare, e përjetoi para disa muajsh Nasim



Haradinaj. Ai nuk mundi të marrë pjesë në varrimin e vëllait të tij, pasi Specialja konsideroi se e pranoi me vonë kërkesën.

E Specialja para pak kohësh ia refuzoi edhe një kërkesë ish-krerëparlamentarit Jakup Krasniqi për një lirim dyjavor

nga paraburgimi. Krasniqi kishte kërkuar të lirohej në kohën e pushimit vjetor të Dhomave të Specializuara.

## “Rishikimi i vizave do ta vriste dialogun”, Osmani kritikohet për gjuhë jodiplomatike

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Reagimi i ashpër i presidentes Vjosa Osmani ndaj paralajmërimeve për rishqyrtim të politikave për vizat nga analistët politikë po shihet jo i duhur dhe aspak diplomatik ndaj aleatëve ndërkombëtarë. Sipas tyre, kërcënimi me heqje dorë nga dialogu me Serbinë nëse pezullohet vendimi për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës nuk është zgjidhja e duhur, pasi Kosova nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut.

Analisti politik Arton Demhasaj thotë për “KosovaPress”, se pavarësisht prej paralajmërimit të presidentit francez, Emmanuel Macron, për rishikim të vendimit për liberalizim të vizave për Kosovën, nëse nuk sillen me përgjegjësi në dialog, e para e vendit, Vjosa Osmani, është dashur të jetë më e matur në deklarimin e saj. Sipas tij, Osmani duhet të jetë më e



përgjegjshme në raport me ndërkombëtarët, pasi Kosova s’është vend faktor i rëndësishëm që ta kërcënojë Francën apo Bashkimin Evropian. “Nuk mendoj se është mënyra e duhur, pasi Kosova nuk është ndonjë vend

i fortë as strategjikisht, ekonomikisht apo ushtarakisht që të mbërrijë ta kërcënojë një shtet siç është Franca, i cili është një prej vendeve kryesore evropiane. Nuk është gjuhë diplomatike që presidentja duhet ta përdorë

ndaj presidentit Macron apo Bashkimit Evropian. Mirëpo është e vërtetë se nëse Bashkimi Evropian merr vendim dhe shfuqizon vendimin për liberalizimin e vizave për Kosovën, do ta dëmtonte dialogun. Por nuk

mendoj se do të shkojë deri tek ajo pikë”, tha ai.

Edhe profesori universitar Mazllum Baraliu kërkon që krerët institucionalë të jenë më të kujdesshëm në deklarimet e tyre ndaj aleatëve ndërkombëtarë. Megjithatë, Baraliu thotë se deklarata e Macronit tingëllonte më shumë si ultimative ndaj Kosovës dhe Serbisë për përparim në dialog. Sipas tij, të dyja palët duhet t’i marrin seriozisht të njëjtat dhe ta zbatojnë marrëveshjen bazë të Brukselit dhe të Ohrit.

Presidenti francez Emmanuel Macron, në një deklaram para ambasadorëve francezë më 28 gusht, ka thënë se vendi i tij do t’i rishikojë zotimet që i ka bërë për çështje ekonomike dhe politika të vizave për Kosovën dhe Serbinë, nëse ato nuk sillen me përgjegjësi në dialog. Ndaj tij ditë më parë reagoi presidentja Vjosa Osmani, e cila tha se një veprim i tillë do ta vriste dialogun Kosovë - Serbi. (kp)



## Analistët: Zgjedhjet përmes peticionit nuk pritet ta zgjidhin situatën në veri të Kosovës

Qeveria e Kosovës pritet që gjatë javës së ardhshme t'i përfundojë aktet nënligjore që i hapin rrugë peticionit për shkarkimin e kryetarëve në veri të Kosovës dhe shpalljes së zgjedhjeve të reja. Por analistët politikë thonë se zgjedhjet përmes peticionit nuk pritet ta zgjidhin situatën në veri. Sipas tyre, shkuarja në zgjedhje përmes peticionit do ta zvarrisë procesin e zgjedhjeve në tërësi

**PRISHTINË, 3 SHTATOR** - Qeveria e Kosovës pritet që gjatë javës së ardhshme t'i përfundojë aktet nënligjore që i hapin rrugë peticionit për shkarkimin e kryetarëve në veri të Kosovës dhe shpalljes së zgjedhjeve të reja. Nëpërmjet këtij dokumenti pritet të përcaktohen rregullat se si të organizohet peticioni, që do t'u mundësonte qytetarëve të komunave shkarkimin e kryetarëve të tyre. Por analistë shqiptarë e serbë thonë se peticioni nuk pritet ta zgjidhë problemin në veri të Kosovës. Politologu serb nga Mitrovica e Veriut, Ognjen Gogiç, thotë për "Zërin e Amerikës" se serbët nuk do t'i nënshtrohen peticionit pasi, sipas tij, ata nuk dëshirojnë të marrin

pjesë në çfarëdo zgjedhje pa u përmbushur kërkesat e tyre. "Pra komuniteti serb në veri nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhjet e reja pavarësisht se në çfarë mënyre do të shkohet qoftë përmes peticionit apo qoftë përmes dorëheqjes së kryetarëve të komunave. Sa i përket peticionit, serbët nuk do të marrin pjesë për t'i mbledhur nënshkrimet sepse kjo do të thotë kthim në institucionet e Kosovës, ende nuk dëshirojnë sepse nuk janë përmbushur disa kushte që janë paraqitur", tha ai. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se dokumenti i qeverisë nuk është i mjaftueshëm për ta mundësuar zhvillimin e procedurave dhe se bie nëndesh me Ligjin për Vetëqeverisje

Lokale. Ai thotë se shkuarja në zgjedhje përmes peticionit do ta zvarrisë procesin e zgjedhjeve në tërësi. "Problematikë është fakti që duhet administruar një proces i tillë në tërësi dhe për të pasur kryetarë të rinj në komunat veriore mund të na duhen të paktën katër deri në gjashtë muaj kohë në rast se ndiqen të gjitha procedurat nominale siç parashihen me udhëzim administrativ, pastaj në bazë të normave dhe standardeve ndërkombëtare, se brenda çfarë periudhe duhet të organizohet procesi i votimit për largimin e kryetarëve", tha ai. Zgjedhjet e reja në veri janë pjesë e hapave për uljen e tensioneve që shpërthyen pasi kryetarët shqiptarë që dolën nga zgjedhjet e 23 prillit të bojkotuar nga serbët, u dërguan në zyrat e komunave veriore me mbështetjen e policisë. Cakolli thotë se zgjidhja më e mirë do të ishte dorëheqja e kryetarëve aktualë pasi që përmes peticionit nuk ka asnjë siguri që pjesëmarrja e komunitetit serb për largimin e kryetarëve mund të pasohet edhe me pjesëmarrje në

zgjedhjen e kryetarëve të rinj. "Kësisoj do të mund të arrijmë në pikën kur edhe pse administrohet një proces i votimit dhe kryhen procedurat, në fakt vetëm kthehemi në pikën e njëjtë ku potencialisht zgjedhen kryetarët e rinj nga radhët e komuniteteve të tjera përveç atyre serbe e që pastaj pritet prapë të shkarkohen nga ana e qytetarëve serbë duke ditur sa kompaktë ata janë në aspektin demografik, por edhe atë të nxitjes nga ana e Listës Serbe apo Beogradit zyrtar për të votuar për largimin e kryetarëve aktualë të komunave", tha ai. Në fillim të muajit qershor Bashkimi Evropian kërkoi uljen e tensioneve përmes pezullimit të operacioneve policore në veri, zhvendosjen e kryetarëve të komunave në zyra alternative dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme me pjesëmarrje të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës. Qeveria e Kosovës tashmë ka përgjysmuar praninë e njëjësive të policisë në ndërtesat komunale në veri dhe është pajtuar për organizimin e zgjedhjeve të reja.

Politologu Gogiç thotë se udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë po dëshirojnë ta mbajnë sa më gjatë krizën në veri në mënyrë që të mos përmbushin detyrimet për të cilat janë zotuar. "Pra edhe njërit edhe tjetrit i konvenon kjo situatë pasi që nuk është më shumë dramatike, kështu që tani është e durueshme, nuk është në atë nivel që mund të ndodhin disa incidente të dhunshme. Mendoj se kjo situatë është më e favorshme për Prishtinën, serbët në veri dhe Beogradin, sepse kjo situatë në veri u mundëson edhe Beogradit edhe Prishtinës të mos përmbushin detyrimet që dalin nga marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit", tha ai. Gogiç thotë se mënyra më e mirë për tejkalimin e krizës në veri të Kosovës është përmes rritjes së trysnisë nga vendet perëndimore, duke pezulluar liberalizmin e vizave për Serbinë dhe Kosovën. Bashkimi Evropian ka paralajmëruar për 14 shtator një takim të nivelit të lartë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, ku do të kërkohen zgjedhje për situatën aktuale ndërmjet dy vendeve.

# Sa ka shpenzuar Kosova në mirëqenie sociale?

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Nga janari deri në korrik të këtij viti Kosova ka shpenzuar mbi 305 milionë euro në përkrahje financiare për personat e pensionuar dhe për ata që janë në skema të ndryshme sociale. Në skemat e tilla përfshihen kategori të ndryshme: nga pagesat mujore për veteranët e luftës e deri te pensionet për kompensimin e punonjësve të arsimit për punën e bërë gjatë viteve 1990. Në raportin e publikuar në fund të gushtit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës janë specifikuar 15 kategori të ndryshme.

Në krahasim me vitin e kaluar, numri i këtyre personave që marrin mbështetje financiare nga buxheti i shtetit ka rënë për 19 mijë. E rënia e numrit të përfituesve ka bërë që gjatë periudhës janar-korrik të këtij viti të ulen edhe shpenzimet nga buxheti i Kosovës për rreth 31 milionë euro më pak sesa gjatë periudhës së njëjtë të vitit



të kaluar. Sipas të dhënave të ofruara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës në raportin "Statistikat e mirëqenies sociale", më së

shumti para janë shpenzuar për pagesat ndaj personave që kanë dalë në pension, ndjekur nga pensionet për veteranët e luftës.

Rreth 19 milionë euro nga paratë e shpenzuara për mirëqenie sociale këtë vit kanë shkuar për pagesat për familjet të cilat jetojnë në varfëri.

Numri më i madh i këtyre pagesave - që maksimumi mund të arrijnë deri në 250 euro për familje dhe shuma varet nga numri i anëtarëve në familje - janë proceduar në komunën e Mitrovicës së Jugut. Në këtë komunë, rreth 8 880 persona morën ndihmë gjatë muajit korrik - shifër kjo dukshëm më e lartë se në cilëndo komunë tjetër. Pas Mitrovicës së Jugut radhitet Vushtrria me gjithsej 5 670 përfitues të ndihmave sociale. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në Kosovë në tremujorin e fundit të vitit 2022 ishte 11.8 për qind. Gjatë këtij viti Qeveria e Kosovës ka shpërndarë edhe ndihma të tjera përmes subvencionimeve të hapura në platformën digjitale E-Kosova, ku qytetarët kanë pasur mundësinë të aplikojnë për pajisje elektrike, izolim të shtëpisë etj.

## Ali Ahmeti me bashkëpartiakë viziton kompaninë "Devolli"

Prishtinë, 3 shtator - Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, bashkë me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi dhe ekzekutivin e Bashkimit Demokratik për Integrim, vizituan këtë fundjavë korporatën "Devolli" dhe fabrikën e prodhimit "Commodita".

Ahmeti në "Facebook" ka treguar për këtë vizitë. "Me mbi 4.900 punëtorë, eksportues në 25 vende dhe me mbi 20 dyqane në Maqedoninë e Veriut, kjo kompani kontribuon në

zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe mbarë rajonit. U diskutua mundësia që korporata Devolli të vazhdojë të shtrijë investimet e veta në prodhim edhe në Maqedoninë e Veriut me brendin Commodita, me ç'rast do hapen mijëra vende pune edhe në vendin tonë", ka shkruar Ahmeti.

Ai ka theksuar se kapacitetet e tyre institucionale janë në shërbim të plotë për t'i mbështetur investimet e drejtpërdrejta që nënkuptojnë jetë më cilësore.



## Veprimtari Bislimi takon ministra e parlamentarë të Zvicrës, temë diskutimi Kosova dhe Gjykata Speciale



Bern, 3 shtator - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, ka takuar ministrin e Jashtëm të Zvicrës, Ignazio Cassis, ministren e Financave, Karin Keller-Sutter dhe parlamentarë të shumtë. Në këto takime Kosova ishte temë diskutimi. "Bashkëbiseduam për shumë çështje dhe gjetëm mirëkuptimin se integrimi i shpejt i Kosovës në Bashkimin Evropian është e vetmja zgjidhje për stabilitet afatgjatë në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor", ka shkruar Bislimi në "Facebook". Ai ka shkruar tutje se: "Ata që

kanë Kosovën për zemër padyshim që janë miqtë tanë më të mirë në të gjitha partitë zvicerane. Unë jam nga ata që mendoj se ne duhet të votojmë miqtë tanë - njerëzit që solidarizohen me Kosovën, tek ata që gjejmë përkrahjen në proceset që kalon Kosova në integritet dhe në gjykatën artificiale të Hagës - aty ku bëhet padrejtësia më e madhe në historinë tonë të re. Në Ministrinë e Jashtme që udhëheqin liberalët dhe vetëm këtu më së miri ndihmohet Kosova".

## Prishtina e ngarkuar me vetura, transporti publik shihet si zgjidhje

**PRISHTINË, 3 SHTATOR** - Prishtina vazhdon të mbetet edhe për një kohë e ngarkuar me automjete shkak i mungesës së rrugëve në kryeqytet. Ndërtimi i rrugëve të kryeqytetit cilësohet jo e mirë nga ekspertët e komunikacionit, shkak i kësaj kryeqyteti bartë në vete bllokadë të automjeteve gjatë gjithë kohës. Sipas tyre, vetëm transporti publik e shpëton Prishtinën nga kolonat.

Muhamed Krasniqi, ekspert i komunikacionit, tha se për shkak të mbingarkesës së automjeteve në rrugët e Prishtinës, qytetarët ballafaqohen gati çdo ditë me kolona dhe tollovi në komunikacion.

Krasniqi shkaktar të kolonave e cilësoi mungesën e rrugëve të reja në Prishtinë si dhe ndarjen e automjeteve se cilat duhet të futen në qendrën e qytetit e cilat jo. "Mendoj se Kosova është shembull i mirë i ndërtimit të rrjetit të rrugor sa iu përket autostradave, mirëpo nuk kemi gjendjen e njëjtë sa iu përket

rrugëve nacionale dhe rrugëve brendapërbrenda mjediseve urbane qysh e kemi qytetin, qendrën e qytetit apo zonën një dhe dy të qytetit. Prandaj e vërejmë më shumë këtë prani të madhe të automjeteve, dhe këtu qëndron krejt problemi për shkak se nuk duhet që të gjitha automjetet të lejohen të futen në qendrën e qytetit", tha Krasniqi.

Ai propozon që qytetarët të mos përdorin automjete brenda rrugëve të qytetit, por të udhëtojnë me forma të tjera të transportit publik.

Se komunikacioni është i dendur gjatë gjithë kohës, thotë edhe Bekim Ahmeti, ekspert i komunikacionit të Kosovës. Sipas tij, në kryeqytet nuk duhet të lejohet asnjë ndërtim në zonat urbane të komunikacionit. Ai thekson se nëse kryeqytetit nuk i ndërtohet transporti hekurudhor, Prishtina do të vazhdojë të ketë kolona të gjata. Zgjidhje momentale Ahmeti e cilëson transportin publik. (kp)



## Klinika e Pediatriisë e stërmbushur me pacientë, dy fëmijë të shtrirë në një shtrat



**PRISHTINË, 3 SHTATOR** - Në Klinikën e Pediatriisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), për shkak të fluksit të madh të pacientëve, po detyrohen që dy fëmijë t'i shtrijnë në një shtrat. Nga kjo klinikë thonë se brenda ditës rreth 140 pacientë kërkojnë ndihmë mjekësore, derisa potencojnë se rreth 30 fëmijë kanë nevojë të hospitalizohen. Ndërkaq, prindërit ankohen për hapësirën e ngushtë, derisa thonë se brenda një dhome të vogël, bashkë me prindër dhe vizitorë, numri shkon deri në 12. Qytetari Ramadan Berisha, i cili e ka të hospitalizuar një familjar, vlerëson se kushtet në Klinikën e Pediatriisë nuk janë të mira. Lidhur me këtë mendim të tij, pediatri në Klinikën e Pediatriisë, Ali Venhari, për "KosovaPress" tha se janë të detyruar t'i vendosin dy pacientë në një shtrat për shkak të numrit të madh të fëmijëve që kërkojnë hospitalizim.

Venhari tregon se gjatë sezonit të verës simptomat që e karakterizojnë virozën janë vjellja, diarreja dhe temperatura. "Faktikisht, brenda emergjencës së Klinikës së Pediatriisë, për rreth 24 orë, i kemi rreth 120-140 vizita. Brenda këtyre vizitave për hospitalizim përafërsisht 20 deri në 30 fëmijë kanë nevojë të hospitalizohen, pjesën tjetër e trajtojmë me terapi. Në këtë kohë më të shpeshta i kemi fëmijët me të vjellja, barkqitje dhe temperaturë, që është një problem gastrointestinal, faktikisht më së shpeshti i shkaktuar nga viruset tash të sezonit", tha ai. Përveç kësaj, pediatri Ali Venhari theksoi se Klinika e Pediatriisë ka nevojë për rritjen e stafit mjekësor, derisa shtoi se janë të furnizuar pjesërisht me barna esenciale. Venhari tregoi se kohën e fundit nuk është paraqitur ndonjë rast që ka rezultuar pozitiv me Covid-19 te fëmijët.

## MASHTI jep 70 bursa në drejtimet deficitare dhe drejtimet teknike

**PRISHTINË, 3 SHTATOR** - Ministri e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka njoftuar se me qëllim të mbështetjes së nxënësve në profile të rëndësishme për tregun e punës, kanë hapur konkursin për bursa për nxënës në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional, në drejtimet deficitare, si dhe bursa për vajza në drejtime teknike. Nagavci ka shkruar në "Facebook" se vlera e bursës

për nxënës do të jetë 500 euro për një vit shkollor. "Numri total i bursave është 70, prej tyre 40 në drejtimet deficitare dhe 30 në drejtimet teknike. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve, ndërsa për drejtimet teknike vetëm vajzat. Bursat për drejtimet deficitare: Teknik për dizajnin e mediave interaktive, instalues elektrik, veterinar, mekatronikë, asistent i

turizmit dhe udhëtimeve, përpunimi i drurit/zdrukthtar, hortikulturë. Bursat për vajza në drejtimet teknike: Metalpunues, Instalues elektrik, instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, automekanik, teknologjia e reciklimit, teknik i sistemeve të TIK-ut.

Nagavci shton më tej se "si ministri do të vazhdojmë të ofrojmë përkrahje për të gjithë nxënësit e studentët pa dallim".



## Aleanca e Biznesit: Rreth 17 mijë të rinj në Kosovë presin nga pesë vjet për t'u punësuar

PRISHTINË, 3 GUSHT - Mesatarisht rreth 17 mijë të rinj në Kosovë presin nga pesë vjet për t'u punësuar. Kështu thotë Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), duke theksuar se brenda vitit tregut i shtohen rreth 25 mijë persona të aftë për punë. "Mesatarisht rreth 17 mijë të rinj presin për punë rreth pesë vjet. AKB ka bërë një studim hulumtues për 10 vitet

e kaluara rreth tregut të punës në Kosovë, ku mesatarisht punësohen rreth 8 mijë të papunë, kurse në tregun e punës shtohen rreth 25 mijë persona të aftë për punë", ka njoftuar AKB-ja në "Facebook". Sipas tyre, Kosova vazhdon të jetë vendi me pagën më të ulët në Ballkan. "Nga studimi del se një i ri duhet të presë rreth pesë vjet për t'u punësuar në

Kosovë për një pagë mesatare rreth 300 euro në muaj si fillestar e pas një deri në dy vjet deri 400 euro. Kosova vazhdon të jetë vendi me pagën më të ulët në Ballkan dhe me natalitetin më të lartë në BE. Me këtë trend aktual Kosova rrezikon të mbetet pa të rinjtë dhe pa fuqi punëtore", është theksuar në njoftimin e AKB-së.



## BQK-ja: Qytetarët e Kosovës rreth 50 për qind të shpenzimeve i përdorën gjatë udhëtimeve në Shqipëri

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Rreth 50 për qind e shpenzimeve të qytetarëve të Kosovës u përdorën gjatë udhëtimeve në Shqipëri, thuhet në raportin e Bilancit të Pagesave të paraqitur nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Sipas BQK-së, shpenzimet e udhëtimit të kosovarëve jashtë vendit për muajin qershor janë rritur për 18 për qind. "Shpenzimet e udhëtimit të kosovarëve jashtë vendit gjatë muajit qershor kanë arritur vlerën e 58.9 milionë eurove, që paraqet rritje prej 18-përqindësh, prej të cilave rreth 46 për qind janë shpenzimet në Shqipëri", njofton BQK-ja.

Për sa iu përket shërbimeve, 90 për qind të shpenzimeve të udhëtimit është krijuar nga diaspora e Kosovës. "Kategoria kryesore e shërbimeve janë shërbimet e udhëtimit. Vetëm gjatë muajit qershor në Kosovë shërbimet e udhëtimit kanë arritur vlerën 141.3 milionë euro. Vitin e kaluar në këtë periudhë kanë qenë 132.3 milionë euro apo 7 për qind më të ulëta se këtë vit. Rreth 90 për qind e shpenzimeve të udhëtimit në Kosovë, përkatësisht 126.6 milionë euro, janë shpenzimet e diasporës. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, diaspora këtë vit ka shpenzuar rreth 15 për qind më shumë", thekson raporti.

Deficiti i bilancit tregtar deri më muajin qershor arriti në vlerën e 2.1 miliardë eurove, që është niveli më i lartë krahasuar me



vitin paraprak, ndërsa shërbimet kanë shënuar bilanc pozitiv, me një rritje prej 36-përqindësh. "Bilanci tregtar në mallra në kuadër të Bilancit të Pagesave deri në qershor 2023 kishte deficit në vlerë prej 2.1 miliardë eurosh, që është deficiti më i madh tregtar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shërbimet, deri në qershor 2023, kanë shënuar bilanc pozitiv në vlerë 553.2 milionë euro, që paraqet rritje prej 36-përqindësh krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit 2022 apo 407.8 milionë euro", vijon BQK-ja.

Institucioni më i lartë financiar në vend njofton se investimet e huaja direkte janë rritur për 14 për qind. "Bilanci i investimeve direkte në Kosovë deri në qershor 2023 shënoi rezultat prej 271.9 milionë eurosh, që tregon se vlera e tyre ishte 374.2 milionë euro, më lart se të investuara nga kosovarët jashtë që janë 101.9 milionë euro. Investimet direkte arritën vlerën e

374.2 milionë eurove e që paraqet rritje prej 14-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit kaluar, prej 327.3 milionë eurosh deri në qershor 2022", shton ky institucion.

Ndërsa investimet e tjera shënuan vlerë negative. "Investimet e tjera (investimet në depozita, kredi dhe në kredi tregtare) deri në qershor 2023 kanë shënuar vlerë negative prej 135.9 milionë eurosh, e cila i atribuohet kryesisht rritjes së

borxhit të jashtëm në Kosovë, në vlerë prej 285.4 milionë eurosh deri në qershor 2022. Bilanci i investimeve në letra me vlerë, pa përfshirë letrat me vlerë në kuadër të aseteve rezervë, deri në qershor 2023 është rritur për 86.7 milionë euro", shton BQK-ja. Në fund të raportit thuhet se asetet rezervë janë rritur për 78.6 milionë euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak rritja ishte 171.8 milionë euro.

## Pagat e ulëta, OShP-së i largohen shtatë punonjës

PRISHTINË, 3 GUSHT - Stafi u pakësua, por jo edhe punët. Organit Shqyrtues të Prokurimit iu larguan së fundmi shtatë punonjës. Arsyet e largimeve janë kryesisht pagesa e ulët, sidomos me ndryshimet e fundit ku, siç bëjnë me dije nga institucioni me status të agjencisë, janë radhitur shumë ulët me koeficient të pagave. "Sa për ilustrim, po ju njoftojmë se ekspertët të prokurimit sikurse që ka

OShP-ja ka edhe në institucionet e tjera të drejtësisë si në Prokurorinë Speciale, të cilët kanë pagën dy apo tri herë më të lartë se një ekspert shqyrtues i OShP-së, i cili merr pagë afër 500 euro, marr parasysh detyrat dhe përgjegjësitë e një eksperti të OShP-së dhe statusit të këtij institucioni si kauzi gjykatë", thuhet në përgjigjen e OShP-së. E rekrutimi i zyrtarëve të rinj po thonë se merr kohë minimum tre muaj, ndërsa procedurat

tashmë kanë filluar. "Zyrtarët që kanë dhënë dorëheqje mbanin pozitën: ekspert shqyrtues, zyrtar ligjor, zyrtar për pranim të ankesave, zyrtar i arkivit dhe zyrtar i IT-së", bëhet me dije.

Ky institucion qëndroi gati dy vjet pa Zyrtar të Teknologjisë, pasi që konkursi u anulua disa herë në mungesë të aplikimeve, që prapë e lidhin me pagën e ulët. Këto zhvillime i përcjell me shqetësim shoqëria civile.



# Bekimi, i dyti pas Aleksandër Moisiut

Nga: **Uliks FEHMIU**

Shkrimtari dhe producenti italian Francesco Skardamalja ka thënë: “Bekim Fehmiu është i vetmi aktor ndërkombëtar nga shtetet komuniste të Lindjes që ka xhiruar në Perëndim gati njëzet vjet, duke thyer perden e hekurt, deri te paraqitja e Gorbaçovit dhe deri te rënia e Murit të Berlinit”...

Për të folur për babain tim, Bekim Fehmiu, më duhet t'i them disa fjalë për gjyshin tim, Ibrahim.

U lind më 1892 në Gjakovë, në familje tregtarësh dhe arsimdashësish. Kreu shkollën normale dhe medresenë në Shkup.

Beiografia e gjyshit tim mund të rrëfëhet shkurt në bazë të emrave të fëmijëve të tij, të cilët ua dha personalisht, duke u përpjekur që ata të jenë emra shqip (në vend të emrave të zakonshëm turq dhe arabë), e të cilët flasin në mënyrë simbolike për idealet që gjakonte.

## GJYSHIN TIM E PËRNDQËN TË GJITHA SISTEMET

Vajza më e madhe Besa – besë, fjalë e dhënë, betim dhe njëllor shenje mbrojtëse e shqiptarëve; Shpresa – shpresë në ditë më të mira për popullin shqiptar; Bashkimi – djali i parë – bashkim i popullit shqiptar; Arsimi – arsimimi i popullit; Fatmiri – fat i popullit; babai im, Bekimi – bekim për popullin; Afërdita – është afër agu për popullin shqiptar; Luljeta – lulëzim i jetës.

Me pushkë e libër në dorë, ishte dorë e djathtë e Bajram Currit, udhëheqës i kryengritjes së popullit shqiptar kundër Turqisë më 1912. Si njëri ndër mësuesit e parë shqiptarë, i përkushtohet arsimimit të popullit të vet dhe hapjes së shkollave si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri. Për këtë shkak, pushteti serbo-malazias e dënon me vdekje.

Në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, përndiqet si ithtar i Bajram Currit dhe i Fan S. Nolit. Gjyshi tim e përndjek edhe mbreti i Shqipërisë, Ahmet Zogu. Ai jep një mijë lira për kokën e tij. Më 1929 arrestohet dhe izolohet në Valevë. Gjatë kësaj kohe, familja e tij jeton në Gjakovë. Më 1931 të gjithë deportohen për në Sarajevë ku, pos tre fëmijëve që kishte, lindin edhe

djemtë Arsimi, Fatmiri dhe, më 1936, babai im, Bekimi.

Më 1939, pas okupimit të Shqipërisë nga Italia, ata kalojnë në Shkodër, ku gjyshi bëhet drejtor didaktik i shkollave fillore dhe ku i lind vajza – Afërdita.

Pas shkatërrimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, më 1941, familja kthehet në Kosovë, në Prizren, ku gjyshi vazhdon punën e tij arsimore dhe patriotike. E burgosin edhe gjermanët.

Rrethi i golgotës së familjes Fehmiu nuk mbyllet as gjatë kohës së Jugosllavisë së re socialiste. Gjyshi e arrestojnë dhe, pas procesit të montuar, ai dënohet me burg. Pak kohë pas daljes nga burgu, më 1951, ai vdes.

Gjyshja ime, Hedija, e lindur në Gjakovë më 1908, ndoqi udhën e gjyshit.

## ME VESHJE KOMBËTARE NË NJU-JORK

Brezi i babait tim, Bekimit, është brezi i parë në historinë e Prizrenit, i cili kreu shkollimin komplet në gjuhën shqipe – nga shkolla fillore e deri në fund të gjimnazit. Pas gjimnazit, babai bëhet anëtar i Dramës Shqipe të Teatrit Popullor të Rrethit, i vetmi teatër profesionist në Prishtinë, gjegjësisht në Kosovë.

Akademine teatrorë e regjistroi në Beograd, më 1956, në klasën e regjisorit dhe profesorit të njohur Mate Milosheviq. E jep provimin dhe pranohet në Akademi, me kusht që të mësojë gjuhën serbokroate.

Teatri i Prishtinës i ndan bursë, por anatema e “zotërave” të politikës, e hedhur mbi familjen Fehmiu, bie edhe mbi babain tim.

Pas dy muajsh, ia ndalin bursën. Falë rektorit të Akademisë, poetit Dushan Matiq, i ndahet bursë deri në fund të studimeve.

Babai shumë shpejt mëson gjuhën serbokroate dhe, më 1960, bëhet anëtar i rregullt i teatrit më të mirë në Jugosllavi – Teatrit jugosllav të dramës. Edhe deri në ditët e sotme, profesorët në Akademinë teatrorë (Fakulteti i Arteve Dramatike) përmendin babain tim si shembull të studentit shumë të talentuar dhe jashtëzakonisht punëtor. Këtë e kam dëgjuar edhe vetë shumëherë, si student i po këtij fakulteti.

Deri më 1987, kur jep dorëheqje nga Teatri jugosllav i dramës për shkak të trajtimit të



dobët dhe bëhet artist i lirë, ka luajtur 40 role: episodike, të mesme dhe kryesore, përfshirë këtu edhe rolet në Ateleun 212. Dy herë ishte asistent i regjisë te profesori Mate Milosheviq. Xhiron edhe filmat “Klakson”, “Roj”, “Udha”, “Vitet e nxehta”, “Protesta”, “Deps”, “Pavle Pavloviq” etj.

Pas suksesit të madh të filmit “Mbledhësit e puplave”, në regji të A. Petroviqit, ku luan rolin kryesor – Beli Bora (filmi fitoi dy shpërblime në Festivalin e filmit në Kanë, Francë, më 1967 dhe nominohet për Oskar më 1968), fillon karriera e tij ndërkombëtare, bëhet yll i parë botëror nga këto hapësira dhe nënshkruan marrëveshjen shumëvjeçare me producentin italian Dino de Laurentis. Bëhet krenari e ish-Jugosllavisë.

Kryesisht xhiron në Evropë, në SHBA, në Amerikën Jugore, në Afrikë, në Azi. Aktroi në gjuhën shqipe, serbokroate, maqedone, rome, turke, spanjishte, angleze, franceze dhe italiane.

Shikuesit edhe sot shikojnë filmat e njohur dhe serialet televizive në të cilat ka luajtur ai, siç janë: “Odiseu” i Homerit me Irena Papsin; “Avanturierët” e Harold Robinsit, ku luajti rolin kryesor – Daksin, gjegjësisht plejbojin Porfir Rubiroz; “Dezertorin” me Xhon Hjustonin, me Riçard Krenin, me In Benenin, me Rikard Montalbanin, me Çak Konorsin, me Vudi Stroudin...; “Leja për vrasje” me Ava Gardnerin, me Dik Bogartin, me Frederik Forestin, me Timoti Daltonin...; “E diela e zezë”, me Robert Sounin, me

Marta Kelerin...; “Liberio, dashuria ime”, me Klaudia Kardinalen; “Salon Kiti”, me Ingrid Tulin, me Helmut Bergerin e shumë të tjerë.

Për të marrë rolin kryesor në filmin multibuxhetor “Avanturierët”, në regji të Luis Gilbertit, të Shtëpisë filmike “Paramount”, iu desh ta zotërojë gjuhën angleze për dhjetë javë. Ky rol iu dha më 1968, kur u lindi unë.

Me qëllim që t’u prezentohej mysafirëve të lartë, si yll i ri i filmit “Avanturierët” me yjet e njohura botërore: Olivija de Hevilend, Ana Mofo, Kendis Bergen, Ernesto Borgnajn, Fernand Rej, Alen Bedel, Rosana Braçi, Sharl Aznavur etj., për të nderuar babain tim organizohet pritje e madhe në hotelin “Pjer” në Nju-Jork. Babai im këtu u paraqit me veshje kombëtare shqiptare.

## HESHTI DHE U SHNDËRRUA NË HESHTJE

Xhironi mbi pesëdhjetë filma, në të cilët kryesisht luajti rolet kryesore.

Në shenjë proteste për shkak të propagandës antishqiptare dhe për shkak të përhapjes së urrejtjes ndaj popullit shqiptar, babai im, Bekimi, më 1987, lëshon demonstrativisht shfaqjen “Madam Kolontajn” (të Anjeta Plejelit), në Beograd, ku luante rolin e Leninit dhe të Stalinit dhe përshëndetet publikisht me veprimtarinë artistike në ish-Jugosllavi.

Roli i fundit, që luajti për televizionin italian, ishte Shën Josifi, në filmin “Fëmija me

emrin Jezus”, në regji të Franko Rosit, film ky që u shfaq edhe në televizionin amerikan.

Shkrimtari dhe producenti i fimit të përmendur, Francesco Skardamalja, ka thënë: “Bekim Fehmiu është i vetmi aktor ndërkombëtar nga shtetet komuniste të Lindjes që ka xhiruar në Perëndim gati njëzet vjet, duke thyer perden e hekurt, deri te paraqitja e Gorbaçovit dhe deri te rënia e Murit të Berlinit”.

Filmi i fundit që xhironi babai im ishte “Xhingis Kan”, në regji të Ken Anekinit, më 1992 (SHBA – Itali).

Pas Aleksandër Moisiut, aktor nga pjesa e parë e shekullit XX, babai im është aktori i parë ndërkombëtar nga shqiptarët, në pjesën e dytë të shekullit XX. Zhbërja e Jugosllavisë, lufta e tmerrshme, shkatërrimi i Vukovarit, bombardimi i Dubrovnikut, rrethimi shumëvjeçar i Sarajevës, lufta në Kosovë, ndikuan që babai im të tërhiqet edhe më shumë. Heshti, e fjalët janë mjeti më i fortë dhe më i mirë për artistin. Heshti dhe u shndërrua në heshtje – në protestë. Hamleti do të thoshte: “... Mbeti heshtja”.

Babai im, Bekim Fehmiu, sot jeton i tërhequr me nënën time, aktoren e njohur Branka Petriq, e cila edhe më tej merret aktivisht me teatër, dhe me motrat e me vëllezërit e vet, ndërmjet Prizrenit, Prishtinës e Beogradit.

Vëllai im, Hedoni, dhe unë me bashkëshorten, Snezhana Bogdanoviç, aktore e njohur, dhe me vajzën Nika, jetojmë në Amerikë. /Telegrafi/



# Si të reduktojmë shpërqëndrimin nga bota dixhitale: Këshilla nga murgjit mesjetarë

Nga Jamie KREINER

Murgjit mesjetarë, harxhonin shumë kohë për t'u përqëndruar. Dhe përqëndrimi ishte puna e tyre kryesore gjatë gjithë jetës! Natyrisht, teknologjia e tyre ishte shumë e ndryshme nga e jona. Por ata nuk kishin ndonjë shqetësim për shpërqëndrimin.

Ata ankoheshin me shpesh se ishin mbingarkuar me informacion, dhe pasi vendosnin të lexonin diçka, e kishin të lehtë të mërzhiteshin, dhe të kapnin për të lexuar diçka tjetër. Ata ishin të frustruar nga dëshira për të parë nga dritarja, ose për të kontrolluar vazhdimisht kohën (në rastin e tyre, me Diellin si referencë), ose të mendonin për ushqimin apo seksin, kur në fakt duhej të mendonin për Zotin.

Ata madje shqetësoheshin, pse shpërqëndroheshin në ëndrrat e tyre. Ndonjëherë akuzonin demonët, se u trazonin mendjen. Nganjëherë bënin me faj instinktet bazike të trupit. Por mendja ishte problemi rrënjësor. Xhon Kasian, reflektimet e të cilit rreth mendimit, ndikuan tek murgjit për shekuj më rradhë, e njihje shumë mirë këtë problem.

Ai ankohej se mendja "duket e nxitur nga inkursione të rastit". Ajo "endet rreth e rrotull, si e dehur". Ajo mendon për diçka tjetër, teksa t'i lutesh apo këndon psallmet. Ajo do të endet mbi planet e saj të ardhshme, apo mbi keqardhjet e të kaluarës pikërisht në mes të leximit.

Ajo nuk mund të qëndrojë e përqëndruar as në argëtimin e vet – lëre më pastaj mbi idetë e vështira që kërkonin një përqëndrim serioz.

Kjo ndodhte në fund të viteve 420. Nëse Xhon Kasian kdo të kishte parë një smartfon, ai do të kishte parashikuar në çast krizën tonë konjitive. Por, në vend të kësaj, mendja e tij ishte fokusuar gjetiu. Kasian shkruante në një kohë kur komunitetet murgjërë të krishtera, po fillonin të zgjeroheshin ndjeshëm në Evropë dhe Mesdhe.

Një shekull më parë, asketët kishin jetuar kryesisht të izoluar. Dhe entuziazmi i ri për ndërmarrjet e përbashkëta, solli një entuziazëm të ri për ndërtimin e manastireve. Këto hapësira të reja sociale, supozohej të funksiononin në një mënyrë më optimale, kur



murgjit të kishin udhëzime se si të kryenin punët e tyre. Puna e tyre, më shumë se çdo gjë tjetër, ishte të përqëndroheshin në komunikimin e tyre hyjnor: të lexonin, të luteshin, të këndonin psallmet, dhe të përpiqeshin ta kuptonin Perëndinë, me synim që të përmirësonin shëndetin e shpirtit të tyre, dhe shpirtit e njerëzve që i mbështesnin.

Për këta murgjërë, mendja meditative nuk duhej të lihej e qetë. Ajo duhej stimuluar vazhdimisht. Fjalët e tyre të preferuara për përkufizimin e përqëndrimit, buruan nga fraza latine "tenere", pra të qëndruarit pranë diçkaje. Ideali ishte një "intent mens", një mendje që ishte gjithmonë aktive, për arritjen e objektivit të saj.

Dhe përmbushja e tij me sukses, nënkuptonte marrjen seriozisht të dobësive të trupave dhe trurit të tyre, dhe të punuarit shumë me to, për t'i bërë mësuar se si të sillëshin. Disa nga këto strategji ishin të vështira. Për shembull, heqja dorë nga diçka. Murgjërët dhe murgeshat, duhej të heqin dorë nga gjërat që donin shumica e njerëzve – familjet, pronat, bizneset, jeta e përditshme – jo vetëm për të shkatërruar ndjenjën e tyre të drejtës individuale, por edhe për të garantuar që ata nuk do të shqetësoheshin nga gjëra të tjera në jetën e tyre profesionale të lutjes.

Kur mendja endet, vërenin teoricienët murgjërë, ajo fokusohet zakonisht në veprimtari të kohëve të fundit. Kushtojani angazhimet tuaja gjërave më serioze, dhe do të keni më pak mendime që do të konkurrojnë për vëmendjen tuaj. Kufizimi duhej të funksiononte edhe në një nivel

fiziologjik.

Në Antikitetin e Vonë dhe në Mesjetë, ka pasur shumë teori mbi lidhjen midis mendjes dhe trupit. Shumica e të krishterëve, binin dakord se trupi ishte një krijesë nevojtare, me një oreks të pafundëm për ushqim, seks dhe komoditet, dhe që e shpërqëndronte mendjen nga ajo që kishte më shumë rëndësi. Kjo nuk do të thotë që trupi duhet të refuzohet, vetëm pse ai ka nevojë për një dashuri të fortë. Për të gjithë murgjit dhe murgeshat në shekullin IV, kjo nënkuptonte një dietë të moderuar ushqimore, dhe pa marrëdhënie seksuale. Shumë prej tyre, angazhoheshin në punë të ndrushme.

Ata e panë se e kishin më të lehtë të përqëndroheshin kur trupat e tyre lëviznin, pavarësisht nëse ishin duke pjekur diçka në furrë, punonin në punë bujqësie apo thjesht shëtisnin.

Kishte ndërkohë edhe zgjidhje, të cilat sot njerëzve mund t'ju duken të çuditshme, të cilat vareshin nga imazhet imagjinare. Pjesë e edukimit në

manastire, përfshinte të mësuarit se si të formoje imazhe figurative të njohura, për të ndihmuar përforcimin e aftësive misterioze dhe meditative të dikujt. Mendja i ka qejf stimujt si ngjyrat, godinat, seksin, dhunën, zhurmën dhe gesticulacionet e egra.

Sfida ishte të pranoje kënaqësitë dhe preferencat e saj, në mënyrë që të përfitoje prej tyre. Autorët dhe artistët mund të kanë më të lehtë në këtë rast, duke shkruar narracione të gjalla, ose duke skalitur figura groteske, që mishërojnë idetë që dëshironin të komunikonin. Por nëse një murgeshë donte të mësonte vërtet diçka që kishte lexuar ose dëgjuar, ajo do ta bënte vetë këtë punë, duke e përshtatur materialin si një seri animacionesh të çuditshme në mendjen e saj.

Le të themi se do të donit të mësonit sekuencën e zodiakut. Tomas Breduordin (drejtues i një universiteti të shekullit XIV, teolog dhe këshilltar i mbretit anglez Eduardi III), sugjeron të imagjinoni një cjamin të bardhë

me brirë të artë, që godet në teskujt një dem të kuq të ndritshëm.

Ndërsa demi përgjaket, imagjinoni një grua para tij që lind binjakë. Dhe kështu me radhë.

Një metodë më e avancuar e forcimit të përqëndrimit, ishte ndërtimi i strukturave mendore të përpunuara gjatë leximit dhe të menduarit. Murgeshat, murgjit, predikuesit dhe njerëzit që ata arsimonin, inkurajoheshin gjithmonë të vizualizonin materialin që po përpunonin.

Një pemë e degëzuar ose një engjëll me pendë të pruarara, një arkë shumëkatëshe në zemër të kozmosit – mund të bëhet modeli për ndarjen komplekse në një sistem të renditur. Imazhet mund të përputhen ngushtë me thelbin e një ideje. Ndërtimi i aparaturave komplekse mendore, i jep mendjes një mënyrë për të organizuar – dhe në proces analizuar – materialin që duhet të mësohet. Çdo strategji për shmangien e shpërqëndrimit, apelon për strategji të ndryshme në këtë drejtim. Kur Kasiani bëri një nga rekomandimet e tij më të thjeshta – përsëriteni pa pushim një psallm, për të mbajtur trurin tuaj të fokusuar – ai e dinte se çfarë do të dëgjonte më pas. "Si mund të qëndrojmë të fiksuar pas një vargu?" - do të pyesin murgjit.

Shpërqëndrimi, është një problem i vjetër, ndaj është fantazia ajo që mund të shmangët njëherë e përgjithmonë. Ndërkohë, rreth 1600 vjet më prë, kishte po aq gjëra emocionuese për të menduar, ashtu siç ka tani. Dhe kjo ndonjëherë, ato duket sikur të bllokohen mendjen.

Aeon – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova rrëmben medaljen e artë ekipore në Ballkanikun e Xhudos

**PEJË, 3 SHTATOR** - Pas tetë medaljeve të arta të fituara të shtunën në gara individuale, sukses të jashtëzakonshëm Kosova

ka arritur edhe të dielën në garën ekipore në këtë sport. Xhudistët tanë kanë fituar medaljen e artën edhe në këtë

kategori duke dominuar totalisht me pesë garues kundër Malit të Zi. Laura Fazliu, Akil Gjakova, Nora Gjakova dhe Loriana

Kuka që të gjithë u treguan të pa konkurrencë, duke mposhtur me lehtësi rivalët e tyre nga Mali i Zi.



# Balkani shkëlqen edhe në Superligë

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 3 SHTATOR** - Kampionia e Kosovës në futboll, Balkani pas kualifikimit në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës, të dielën ka shënuar fitore në Albi Mall Superligë ndaj Gjilanit me rezultat 2-0. Skuadra e drejtuar nga Ilir Daja kaloi e para në epërsi në minutën e 19-të, kur shënoi Albin Krasniqi për 1-0. Pjesa e parë u mbyll me këtë rezultat, derisa pas një ore lojë mysafirët barazuan rezultatin me golin e Oltion Bilallit. Transferi i ri i Ballkanit Arb Manaj (78') realizoi golin e fitores për rezultatin 2-1. Në ndeshjen tjetër Drita nuk arriti me shumë se një barazim ndaj Dukagjinit (2-2). Klubi nga Klina kaloi në epërsi përmes Bujar Shabanit, në

minutën e 30-të, por Drita përmes dy golave të Besnik Krasniqit përmbysi rezultatin në minutat 40-të dhe 45-të. Megjithatë, Dukagjini barazoi shifrat në minutën e 65-të me golin e Gashit. Merita të mëdha për një pikë të skuadrës nga Klina pati portieri Kenan Haxhihamza, i cili në minutën e 92-të priti gjuajtjen e Besnik Krasniqit nga penalltia. Ndërkohë, ndeshja ndërmjet Llapit dhe Prishtinës në "Zahir Pajaziti" nuk ka prodhuar fitues e as gola. Ndërsa të shtunën Liria ka realizuar fitoren e parë pas rikthimit në Superligë, duke triumfuar para tifozëve të vet ndaj Fushë Kosovës, në ndeshjen e javës së 4-të, me rezultat 2-1. Liria kaloi në epërsi në minutën e 34-të përmes Melos Zenunajt, por mysafirët barazuan rezultatin në



minutën e 66-të me golin e Dominik Ivkiq. Për tri pikët e para të Lirisë u përkujdes Zenunaj, i cili në minutën e 89-të shënoi golin e tij të dytë, duke vendosur rezultatin

përfundimtar të ndeshjes. Ndërkohë, Malisheva është rikthyer fuqishëm pas humbjes nga Prishtina një javë më parë, teksa e ka mundur Feronikelin 74, me rezultat 4-1. Golat për

**SUPERLIGA**

|                        |     |
|------------------------|-----|
| Drita - Dukagjini      | 2-2 |
| Balkani - Gjilani      | 2-1 |
| Llapi - Prishtina      | 0-0 |
| Liria - Fushë Kosova   | 2-1 |
| Malisheva - Feronikeli | 4-1 |

| Tabela           |   | Pikë |
|------------------|---|------|
| 1. Malisheva     | 4 | 9    |
| 2. Balkani       | 3 | 9    |
| 3. Prishtina     | 4 | 8    |
| 4. Llapi         | 4 | 7    |
| 5. Drita         | 3 | 5    |
| 6. Liria         | 4 | 5    |
| 7. Feronikeli 74 | 4 | 3    |
| 8. Dukagjini     | 4 | 2    |
| 9. Gjilani       | 3 | 1    |
| 10. Fushë Kosova | 3 | 0    |

Malishevën i shënuan Ilir Mustafa (43'), Donat Vitija (51'), Robert Matheu (71') dhe Oshafi (84'), ndërsa golin e vetëm për skuadrën nga Drenasi e realizoi Berisha (45').

## Verstappeni merr fitoren e dhjetë me radhë, shkruan historinë në Formula 1

Monza, 3 shtator - Në Çmimin e Madh të Italisë në e Monza, fitoi Max Verstappen duke regjistruar fitoren e dhjetë radhazi në botën e Formula 1. Ky është një rekord unik për holandezin pasi askush më parë nuk kishte mundur të regjistronte kaq fitore të njëpasnjëshme. Dy herë Kampioni i Botës e nisi nga vendi i dytë garën, teksa Carlos Sainz ishte i pari. Megjithatë, spanjoli u detyrua të dorëzohej në xhiron e 15-të, kur Verstappen e parakaloi pavarësisht se piloti i Ferrarit rezistoi jo pak. Në vijim, Sainz e humbi pozicionin edhe ndaj Sergio Perez i cili e mbylli garën në vendin e dytë. Megjithatë, në fundin e garës piloti spanjoll luftoi shumë dhe



ia doli të siguronte vendin e tretë duke lënë jashtë podium shokun e skuadrës, Charles Leclerc, i cili u detyrua të kënaqej me vendin e katërt. Nga ana tjetër, dyshja e Mercedes e mbylli në vend të pestë dhe të gjashtë, teksa Russell u rendit para Hamilton.

Ndërkohë, në zonën e pikëve u renditen Albon, Norris, Alonso dhe Bottas. Pas kësaj fitoreje, Verstappen bëhet edhe më i pakapshëm në krye të renditjes dhe titulli i tretë botëror mbetet vetëm një formalitet për holandezin.

## Arenali mposhti Unitedin në derbi

**LONDËR, 3 SHTATOR** - Arsenali ka arritur një fitore në frymën e fundit ndaj Manchester United në shifrat 3-1. Marcus Rashford shënoi një gol mjaft të bukur duke mposhtur me një goditje të bukur portierin Aaron Ramsdale. Megjithatë, reagimi i "Topçinjë" nuk vonoi dhe erdhi vetëm një minutë më pas me anë të Martin Odegaard që shfrytëzoi në maksimum një pasim të Martinellit. Në pjesën dytë,

skuadra e Mikel Artetës provoi në disa raste të godiste kuadratin e portierit Onana, por pa pasur saktësinë e duhur. Arsenali nuk e kishte thënë ende fjalën e fundit pasi në 96-tën, Declan Rice çoi peshë tifozët në "Emirates" kur shënoi me një goditje të fortë nga brenda zonës. Unitedi nuk kishte kohë për të reaguuar dhe pësoi edhe një tjetër gol me anë të Gabriel Jesus, që shënoi me një veprim të bukur.



## Rashica shënon dhe asiston në fitoren e Beshiktashit

**STAMBOLL, 3 SHTATOR** - Beshiktash është rikthyer te fitorja në Superligën e Turqisë pas barazimit me Petiksporin javën e kaluar. Skuadra e drejtuar nga Senol Gunes fitoi sonte

ndaj Sivassporit, në ndeshjen e vlefshme për javën e katërt në elitën e futbollit turk. Ndeshja e zhvilluar në "Vodafone Park" përfundoi me rezultatin e pastër 2-0.

Milot Rashica la gjurmë në këtë takim, duke shënuar golin e tij të parë me fanellën e Beshiktashit. Repreruesi i Kosovës ishte autor i golit të dytë (40'), teksa sonte luajti për

63 minuta. Omar Colley (25') shënoi golin tjetër. Beshiktash pas kësaj fitore ka shtatë pikë dhe renditet i treti në tabelë. Sivasspor pozicionohet në vendin e 10-të me pesë pikë.



